



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001866/4

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandim për përmirësimet ligjore në funksion të mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi për punë, si dhe nga punët e rënda për ta.

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

TIRANË

Më lejoni, që nëpërmjet këtij rekomandimi, institucioni i Avokatit të Popullit të ndajë me Ju qëndrimet, të cilat, gjykojmë se do të përbëjnë disa nga sfidat kryesore në përmbushjen e detyrave dhe kompetencave ligjore, lidhur me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave në praktikë.

Institucioni i Avokatit të Popullit është vënë në dijeni, nga mediat *online*, lidhur me fenomenin e shfrytëzimit për punë të rënda dhe të dëmshme për shëndetin e fëmijëve, nga subjekte të ndryshme të industrisë fasone në vendin tonë. Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes "*ex-officio*" për rastin në fjalë.

Konkretisht, evidentohet se, nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, janë vendosur sanksione administrative të pezullimit të veprimtarisë së subjekteve private, si masë ndëshkuese, për rastet kur ka rezultuar punë e parregulluar me kontratë dhe sigurime për fëmijët në industrinë fasonë.

Misioni i përgjithshëm i ISHPSHSH-së¹ është garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe atij të shërbimeve shoqërore. Pra, ky inspektorat është përgjegjës për inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore të punës, sipas legjislacionit në fuqi, që rregullon këtë fushë veprimtarie.

Në këtë kontekst, institucioni i Avokatit të Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes dhe, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore², ka informuar, se natyra e punës në subjektet me aktivitet fason, është veprimtari ku janë të punësuar kryesisht punëmarrëse femra. Kështu, ai është sektori që ka gjeneruar një numër jo të vogël ankesash të adresuara për zgjidhje nga ana e këtij inspektorati. Objekti i këtyre ankesave ka qenë kryesisht, cenimi i marrëdhënieve të punës, vonesa në dhënien e pagave, mosderdhje e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, largim i padrejtë nga puna, si dhe për kushte pune jo të favorshme.

Gjatë periudhës janar 2019 - shkurt 2020, nuk ka patur asnjë denoncim pranë këtij inspektorati, nga punonjës të mitur apo me shkak punësimi jashtë kriterëve ligjore të punëmarrësve nën 18 vjeç, për fasoneritë e vendit.

Ndërkohë, që gjatë kësaj periudhe, nga inspektimet e kryera në këto ndërmarrje me aktivitet fason, janë konstatuar 108 punëmarrës në moshën 18 vjeç.

Në analizë të kuadrit ligjor dhe institucional në fuqi, që rregullon këtë problematikë, vlen të përmbledhim sa më poshtë vijon:

Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, garantohet mbrojtja e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor; cenon edukimin; dhe është e detyruar. Po ashtu, ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk

¹Vendimi nr.295, datë 20.3.2013, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”.

² Referuar shkresës nr.K5/9-2 prot., datë 13.2.2020, përgjigja nëpërmjet shkresës nr.430/1 prot.

dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune të detyruar brenda familjes së tij, në shkollë, institucione të rehabilitimit dhe dënimit, ose në aktivitete kulturore, artistike, sportive, modelimi ose për qëllime reklamuese, që paraqet rrezik, cenon edukimin, dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.

Gjithashtu, ky ligj³ parasheh detyrimin për të raportuar rastet e fëmijëve në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nga të gjithë punonjësit, që punojnë me fëmijët. Kjo gjë sjell nevojën për të mbështetur strukturat që punojnë me fëmijët dhe për t'i riorientuar në punën e tyre. Në vijim, edhe neni 69 i këtij ligji, ka përcaktuar se shkelja e të drejtave të parashikuara në nenin 24 të tij, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë. Në këtë rast, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organi, i cili konstaton kundërvajtjen administrative, vendos dhe ekzekuton sanksionet administrative⁴.

Vendimi nr.129, datë 13.3.2019, i Këshillit të Ministrave “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”, ngarkon Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si një nga mekanizmat shtetërorë përgjegjës për zbatimin e tij, dhe si struktura kryesore përgjegjëse, për identifikimin e rasteve të fëmijëve që shfrytëzohen ekonomikisht.

Ligji nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në RSH”, i ndryshuar, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 2, të nenit 4, përcakton shprehimisht se: ***“...qëllimi i veprimtarisë së inspektimit, arrihet nëpërmjet, këshillimit të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore dhe urdhërimit të korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre...”***. Koordinimi dhe bashkëpunimi për sigurinë dhe shëndetin në punë, ndërmjet institucioneve shtetërore realizohet nga Inspektorati Qendror. Funksionet e tij përfshijnë bashkërendimin e aktiviteteve inspektuese, udhëheqjen metodologjike për aktivitetin e inspektimit dhe

³ Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

⁴ Në kuadrin e mbrojtjes dhe garantimit të një kornizës ligjore të plotë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve, i kemi kërkuar ASHMDF informacion lidhur me procesin, si dhe për rastet e mundshme të konstatimeve të kundërvajtjeve administrative nga subjektet private, për shkelje të nenit 24 të këtij ligji, duke patur si udhërrëfyes mbrojtjen e interesit më të lartë të tyre.

mbikqyrjen e përgjithshme të inspektimit. Ai krijon dhe mirëmban një portal unik⁵ për inspektimin, i cili shërben si një platformë për planifikimin dhe koordinimin e inspektimeve, për shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave për inspektoriatet e ndryshme dhe për informimin e publikut.

Pika 4, e nenit 16, të këtij ligji parasheh, se Inspektorati Qendror⁶ ka të drejtë të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e inspektorateve shtetërore dhe të inspektojë dosjet e inspektimit, si dhe çdo dokument tjetër të lidhur me programimin e kryerjen e procedimeve administrative të inspektimit.

Për këtë qëllim i jemi drejtuar këtij inspektorati, për t'u informuar lidhur me inspektimet e kryera, qoftë edhe jashtë programit, ashtu siç e parasheh neni 25 i ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në RSH", i ndryshuar dhe masat ligjore të ndërmarra për verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore për subjektet, në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së fëmijëve nga shfrytëzimi i tyre në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Nenet 6, pika 2, dhe 24, të ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcaktojnë, se realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve mbështetet në një nga parimet kryesore, që Konventa e OKB-së dhe ky ligj parashohin, atë të respektimit të dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, duke garantuar kështu, zhvillim të qëndrueshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social. Realizimi në praktikë i këtij parimi nga ana e autoriteteve shtetërore përgjegjëse, do të thotë ofrimi i mbrojtjes për fëmijët nga çdo lloj forme dhune, duke i ofruar mbrojtje⁷.

⁵Vendimi nr.696, datë 16.8.2013, i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-Inspektimi".

⁶Vendimi nr.630 datë 14.9.2011, i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror".

⁷"Mbrojtje e fëmijës", është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që: a) paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor; b) cenon edukimin; c) është e detyruar. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune të detyruar brenda familjes së tij, në shkollë, institucione të rehabilitimit dhe dënimit, ose në aktivitete kulturore, artistike, sportive, modelimi ose për qëllime reklamuese, që paraqet rrezik, cenon edukimin, dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Ndalohet çdo praktikë, nëpërmjet së cilës fëmija detyrohet të kryejë veprime të përmendura në pikat 2 e 3, të këtij neni, pavarësisht dënisë ose jo të prindit ose kujdestarit, si dhe pavarësisht faktit nëse është apo jo kundrejt shpërblimit. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si

Vendimi nr.108, datë 15.2.2017, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë”, përcakton kërkesa të hollësishme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të fëmijëve nën 18 vjeç nga shfrytëzimi ekonomik dhe çdo lloj pune që mund të dëmtojë sigurinë dhe shëndetin e tyre, ose fizik, zhvillimin mendor, moral dhe shoqëror dhe ndërhyjnë në edukimin ose pjesëmarrjen e tyre në aktivitete kulturore dhe tregtare. Fëmijët, midis moshës 16 dhe 18 vjeç, mund të punojnë, por janë të kufizuar nga puna e kryer gjatë natës, ose puna që konsiderohet e dëmshme për shëndetin ose rritjen e tyre dhe, në të gjitha rastet, angazhimi i tyre duhet të autorizohet nga Inspektorati Qendror. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale ka marrë masa ligjore në rastet e shkeljeve të dispozitave ligjore, që rregullojnë punësimin e fëmijëve.

Për të shmangur problemet që lidhen me zbatimin e ligjit, për të rritur cilësinë e masave lidhur me mbrojtjen e fëmijës dhe për të përmirësuar performancën e agjencive përkatëse shtetërore, është me shumë rëndësi që të përcaktohen role dhe funksione të qarta për autoritetet qendrore, që janë përgjegjës për zbatimin e politikave lidhur me mbrojtjen e fëmijës, për bashkërendimin e veprimtarive në nivel vendor lidhur me mbrojtjen e fëmijës. Në mbështetje të legjislationit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin korrekt të këtij legjislationi, mbrojtja nga çdo formë e dhunës, neglizhencës e abuzimit dhe forcimi i shëndetit fizik e emocional të fëmijëve, është një komponent i të drejtave të tyre, në interesin më të lartë, si dhe duhet të ketë përparësi të jashtëzakonshme.

Ligji nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, në nenet 34 dhe 35 të tij, ka përcaktuar masat që marrin punëdhënësit për mbrojtjen e të miturit⁸. Megjithëse me vendimin nr.1039, datë 4.12.2013, Këshilli i

dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.

⁸ Neni 34 i këtij ligji parasheh se : *“...Të miturit mbrohen nga çdo lloj rreziku, që vë në rrezik mirëqenien si dhe zhvillimin e tyre, si rrjedhojë e mungesës së përvojës, informacionit për një rrezik potencial të mundshëm apo për shkak se ende nuk kanë arritur plotësisht pjekurinë e tyre. Puna e të miturve ndalohet në rast se ajo: a) objektivisht kalon përtej kapacitetit fizik dhe psikik të tij; b) përfshin ekspozim të agjentëve toksikë, kancerogjenë, shkakton dëmtime të trashëgueshme gjenetike apo dëmtime, të cilat kanë efekte kronike në dëm të shëndetit përgjatë të gjithë jetës; c) përfshin ekspozim në rrezatime radioaktive; ç) përfshin rrezikun e aksidenteve, të cilat mund të ndodhin, të cilat nuk mund të njihen apo të shmangen nga të miturit, për shkak të pakujdesisë së vëmendjes apo të pamjaftueshmërisë së përvojës apo të formimit; d) përbën rrezik për shëndetin si pasojë e të ftohtit apo të nxehtit ekstrem, zhurmave apo dridhjeve...”*

Neni 35 po aty, përcakton se *“...Punëdhënësi merr masa të nevojshme në mbrojtje të sigurisë dhe të shëndetit në punë për të miturit, duke marrë parasysh rreziqet specifike, sipas përcaktimeve në pikën 2 të nenit 34 të këtij ligji. Punëdhënësi merr masa për vlerësimin e rreziqeve për të miturit në punën e tyre, i cili duhet të kryhet para fillimit të punës. Punëdhënësi, pas vlerësimit të kryer sipas pikës 2 të këtij neni, nëse konstaton ekzistencën e rrezikut për sigurinë dhe shëndetin në punë, si*

Ministrave⁹ ka përcaktuar rregullat për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës, nuk është përmbushur detyrimi ligjor për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Ndërmintor për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, siç e përcakton neni 36 i ligjit të sipërpërmendur¹⁰.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020¹¹, ka si vizion krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psiko-social të fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha proceset, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Në përmbajtje të këtij dokumenti, lidhur me objektivin mbi përmirësimin e aksesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, parashihen si objektiva zgjerimi i termave të referencës të pozicionit të inspektorëve të punës, duke përfshirë inspektimin për punën e detyruar të fëmijëve dhe trafikimin e tyre, si dhe shtimi i numrit të punonjësve të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale me 20%.

Avokati i Popullit e ka evidentuar tash, se në Shqipëri mungon një sistem shtetëror i unifikuar i të dhënave, i cili mundëson evidentimin e rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve për punë¹². Institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar punën për hartimin e planit kombëtar të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge për vitet 2019-2021. Në këtë dokument parimisht, janë përfshirë shumë aktivitete, të cilat janë në përputhje me rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit të publikuara në raportin e veçantë, konkretisht si:

-ngritja e një sistemi shtetëror të unifikuar i të dhënave, i cili mundëson evidentimin e rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve për punë.

dhe për zhvillimin mendor e fizik të të miturve, kryen një vlerësim periodik dhe kontroll mbi shëndetin e të miturit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi. Nëse gjatë marrëdhënieve të punës së të miturit ndodh një ndryshim i rëndësishëm në kushtet e punës, punëdhënësi tregon kujdes për: a) planifikimin, ekspozimin e vendit të punës; b) natyrën, llojin, nivelin dhe kohëzgjatjen e ekspozimit ndaj agentëve fizikë, biologjikë, kimikë dhe ergotamikë e psiko-socialë; c) formën, shtrirjen dhe përdorimin e aparaturave të punës, në veçanti të agentëve, të makinerive, aparaturave dhe mekanizmave, si dhe mënyrat e përdorimit; ç) masat e organizimit të procesit të punës, si dhe mënyrat e kombinimit të tyre; d) nivelin e formimit dhe instruksionet që jepen për të miturit. Punëdhënësit përcaktojnë shërbime mbrojtëse dhe parandaluese për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë për të miturit...”.

⁹“Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë këshill”.

¹⁰ Sjellim në vëmendje, se edhe pse Këshilli i Ministrave, mund të ketë përcaktuar një tjetër mënyrë dhe qasje ndaj “komiteteve ndërministrorë”, si organe konsultative të tij, për sa kohë ngritja e këtij komiteti ndërministror për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë është një detyrim ligjor, ai duhet të zbatohet. Në të kundërt, është i nevojshëm rishikimi i ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, për shfuqizimin e dispozitës konkrete që parashikon krijimin e këtij komiteti.

¹¹ Miratuar me Vendimin nr.372, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave.

¹²Në Raportin e veçantë të vitit 2018 të Avokatit të Popullit mbi dukurinë e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve në stogjet e kromit, Bashkia Bulqizë.

- ofrimin e procedurave të qarta për ndërhyrjet e profesionistëve, për një qasje proaktive brenda sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve në ndihmë të fëmijëve që shfrytëzohen për punë;
- përcaktimin e roleve dhe detyrimeve të ofruesve të shërbimeve dhe strukturave përgjegjëse për të kuptuar më mirë çfarë duhet të bëjë secili dhe, çfarë duhet të presin nga njëri-tjetri në punën me fëmijët që shfrytëzohen për punë;
- përcaktimin e treguesve të monitorimit dhe të vlerësimit të procedurave për të siguruar suksesin në ndërhyrje dhe llogaridhënien e ndërsjellë, ndërmjet të gjithë aktorëve dhe strukturave përgjegjëse të përfshirë në punën me fëmijët që shfrytëzohen për punë.

Është detyrë e të gjithëve së bashku, që në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe, në zbatim të parimit të interesit më të lartë të tyre, të përpiqemi t'u garantojmë një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme e pa privilegje. Puna e fëmijëve mund të adresohet përmes rritjes së niveleve të mbrojtjes sociale, promovimit të masave parandaluese, rritjes së ndihmës financiare dhe shërbimeve sociale, zhvillimit të shërbimeve të inspektimit të punës, politikave të tregut të punës dhe nxitjen e arsimit, formimit profesional. Shërbime të tilla si kujdes mjekësor, këshillim psikologjik, ndihmë juridike, vlerësim dhe monitorim të nxitjes dhe riintegritimit konsiderohen në rang global, si vendimtare për përfshirjen e suksesshme sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve që janë viktimë të formave më të këqija të punës së fëmijëve.

Kompleksiteti i çështjes së punës së fëmijëve kërkon përpjekje shtesë për të integruar politikat ekzistuese dhe legjislacionin në një kornizë të vetme, që do të lejojë veprime më efikase dhe efektive për të mbrojtur fëmijët dhe parandaluar dhe eliminuar punën e fëmijëve, përfshirë format e saj më të këqija.

Nga analiza e legjislacionit, identifikojmë disa probleme, të cilat është e nevojshme të adresohen, me qëllimin e rregullimit të mëtejshëm me akte nënligjore:

- përcaktimi i procedurave të qarta e të sakta, për licencimin e shërbimeve të jashtme të parandalimit, edukimin dhe certifikimin e specialistëve dhe shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- ngritjen e Këshillit Ndërmnistror për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë;

- ngritjen e një Task Force për mbrojtjen e fëmijëve, parandalimin, eliminimin dhe rehabilitimin e fëmijëve të shfrytëzuar për punë, përfshirë format e saj më të këqija¹³;
- përcaktimi i indikatorëve në sistemin e mbrojtjes sociale, për monitorimin e punës së fëmijëve, duke përfshirë edhe punën e fëmijëve në bujqësi, si dhe,
- përcaktimin në mënyrë të qartë të mandatit të Inspektoratit të Punës, në lidhje me ekonominë informale dhe bujqësinë.

ISHPPSHSH¹⁴, në komunikimin zyrtar me institucionin e AP-së, informoi edhe rreth programeve mujore të inspektimit. Këto programe hartohen, duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, ku një nga elementët prioritarë është verifikimi për mbrojtjen e sigurisë së fëmijëve nga shfrytëzimi i tyre, në kundërshtim me legjislacionin e punës në fuqi. Kompanitë fason janë në vëmendjen e këtij inspektorati për kontrole të shpeshta, jo vetëm për numrin e konsiderueshëm të punëmarrësve, por edhe si aktivitet që punëson persona nën 18 vjeç. Për periudhën janar-maj 2020, inspektorati ka konstatuar 22 fëmijë që punojnë në subjektet fason, për të cilët nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore të punësimit të tyre. Pozicioni i punës së tyre përfshihet në kategorinë e punëve të lejuara për këtë grup moshe dhe, nuk kanë regjistruar asnjë denoncim për punësime të paligjshme të punëmarrësve nën 18 vjeç.

Përfundime në frymën e detyrimeve nga konventat e traktatet ndërkombëtare

Tash, të gjithë jemi të vetëdijshëm, që lufta kundër ushtrimit të dhunës e shkeljeve ndaj të drejtave të fëmijëve është përgjegjësi e shtetit. Zbatimi i saj në praktikë, ndër vite ka qënë puna dhe angazhimi maksimal i të gjithë aktorëve publikë dhe jo publikë, por jo vetëm, edhe i organizatave ndërkombëtare, institucioneve të pavarura, institucioneve të Bashkimit Evropian, për përmirësimin e kuadrit ligjor në vazhdimësi, organizimin e trajnimeve të ndryshme, për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve, që janë në shërbim të drejtpërdrejtë me fëmijët, si dhe organizimit të fushatave ndërgjegjëse.

Shqipëria ka ndë marrë hapa të rëndësishëm dhe po bën përparim në rrugën drejt integritimit evropian, në zhvillimin dhe përmirësimin, për sa i përket miratimit të legjislacionit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe me numrin më të madh të konventave të ratifikuara të ILO-s. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në nenin 4 të saj, ndalon punën e detyruar, përfshirë këtu edhe punën

¹³ There is also a need to strengthen the system of monitoring child labour. Albania 2019 Report, 2019 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 29.5.2019, European Commission.

¹⁴Nëpërmjet shkresës nr.1089/1, më datë 15.6.2020.

e fëmijëve. Konventa e OKB “Për të drejtat e fëmijës”, veçanërisht, i kërkon Shteteve të përdorin të paktën tre instrumente minimale të mbrojtjes së fëmijëve në këtë drejtim¹⁵, si vijon: vendosjes së një moshe minimale për pranimin në punë, rregullore të përshtatshme për orët e punës dhe kushtet e punës, si dhe vendosjes së sanksioneve të duhura për të siguruar mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik. Konventat e ILO-s mbi Punën e Fëmijëve¹⁶ (nr.138 dhe nr.182) ilustrojnë format më të rënda të punës së fëmijëve dhe bëjnë thirrje për sinergji midis inspektorëve dhe sektorit të arsimit, shërbimeve sociale dhe shëndetësisë, në mënyrë që të eliminohet puna e fëmijëve.

Të gjitha këto akte ndërkombëtare në brendinë e tyre kanë synuar në disa raste të parashikojnë rregullime të përgjithshme dhe në disa të tjera, të përcaktojnë rregulla të detajuara për mbrojtjen e fëmijëve dhe punën e tyre. Duhet theksuar, se standardi i vendosur në këto akte është i detyrueshëm për t’u zbatuar dhe mekanizmat e kontrollit që ato kanë, veprojnë për të siguruar dhe monitoruar zbatimin e drejtë të tyre në praktikë nga shtetet palë në to.

Mbrojtja e fëmijëve është gjithashtu, komponent i secilit nga Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillim të Qëndrueshëm. OKB e ka shpallur vitin 2021, si vitin ndërkombëtar të eliminimit të punës së fëmijëve¹⁷ dhe, kjo përbën një përpjekje për zhdukjen e çdo forme abuzimi dhe shfrytëzimi, si dhe një tregues për realizimin e Objektivit 8.7. të Zhvillimit të Qëndrueshëm¹⁸.

Për realizimin e angazhimeve për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG), për t’i dhënë fund punës së fëmijëve, qeveria, biznesi, sektori financiar dhe shoqëria civile duhet të merren dhe të luftojnë shkaqet e këtij fenomeni, si përcaktuesit e arsyt kryesore të këtyre shkeljeve të të drejtave të njeriut. Një mjedis mbrojtës, që përfshin të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku ligjet, shërbimet, sjelljet dhe

¹⁵Neni 32 i KDF kërkon, ndër të tjera, që: *“...Shtetet të mbrojnë fëmijët nga “shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që ka të ngjarë të jetë e rrezikshme ose të ndërhyjë në edukimin e fëmijës, ose të jetë e dëmshme për shëndetin e fëmijës ose fizik, mendor, shpirtëror, zhvillimi moral ose shoqëror”. Shtetet duhet të marrin masa, duke përfshirë përcaktimin e një moshe minimale për pranimin në punë, rregullimin e duhur të orëve dhe kushteve të punësimit, dhe sanksionet e tjera për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni...”*.

¹⁶Këto përfshijnë:Konventën nr.138, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për moshën minimale për pranimin në punë” dhe Konventën nr.182, e ILO-s “Për format më të këqija të punës së fëmijëve”.

¹⁷2021 International Year for the Elimination of Child Labour. Në korrik 2019, Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi një rezolutë ku u deklarua viti 2021 si Viti Ndërkombëtar i Eliminimit të Punës së Fëmijëve, duke caktuar si kryesuese të zbatimit të kësaj nisme ILO-n (Organizatën Ndërkombëtare të Punës), linku:www.un.org.

¹⁸Objektivi 8.7 për Zhvillim të Qendrueshëm në Shqipëri, në kuadër të Agjendës 2030 “Të merren masa të menjëhershme dhe efektive për të çrrënjësuar punën e detyruar, për t’i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe të sigurohet ndalimi dhe eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve, përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve si ushtarë, dhe deri në vitin 2025 t’i jepet fund punës së fëmijëve në të gjitha format e saj”.

praktikat zvogëlojnë rreziqet, me të cilat përballen fëmijët, si dhe forcojnë elasticitetin e tyre, mund të parandalojë ndodhinë e shumë formave të dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit ndaj fëmijëve.

Periudha e pandemisë COVID-19 dhe kriza globale e shëndetit, i ka lënë shumë fëmijë jashtë detyrës të shkollave dhe, presionet ekonomike ndaj familjeve vazhdojnë të rriten. Kjo mund të pasjellë të tjerë fëmijë që punojnë. Fëmijët që kanë punuar, tashmë ka të ngjarë të jenë më të ekspozuar ndaj virusit (përhapja e mëtejshme në rritje) dhe të përballen me rreziqe më të mëdha, për të rënë në format më të këqija të punës së fëmijëve.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës, i ka kushtuar një vëmendje të posaçme, bashkëveprimi thelbësor midis sektorit të biznesit dhe të drejtave të fëmijëve, si dhe faktit që mjaft kompani dhe subjekte private, shkelin e dhunojnë të drejtat e fëmijëve¹⁹. E po ashtu, edhe mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik dhe format më të rënda të punës së tyre²⁰.

Nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe UNICEF-i, miliona fëmijë të tjerë rrezikojnë të bëjnë punë të detyruar si pasojë e krizës së COVID-19, çka mund të çojë për herë të parë në rritjen e nivelit të punës së detyruar të fëmijëve pas 20 vitesh progresi në këtë drejtim. Mbrojtja sociale është jetike në kohë krize, pasi iu ofron ndihmë personave më të cenueshëm. Integrimi i shqetësimeve mbi punën e detyruar të fëmijëve në politikën e gjera për arsimin, mbrojtjen sociale, drejtësinë, tregjet e punës, dhe të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe të punës, mund të sjellë ndryshime kyçe. Sipas dokumentit përmbledhës, COVID-19 mund të çojë drejt rritjes së nivelit të varfërisë, e rrjedhimisht drejt punës së detyruar të fëmijëve, pasi familjet do të shfrytëzojnë çdo mundësi për të mbijetuar. Teksa rikonceptojmë botën pas COVID-19, duhet të sigurohemi që fëmijët dhe familjet e tyre i kanë instrumentet e nevojshme për të përballuar “stuhi” të ngjashme në të ardhmen. Dokumenti përmbledhës propozon një sërë masash për të luftuar kërcënimin e rritjes së nivelit të punës së detyruar të fëmijëve, duke përfshirë mbrojtjen sociale gjithëpërfshirëse, dhe më shumë burime për inspektimin e punës dhe zbatimin e legjislacionit²¹.

Avokati i Popullit, është një nga aktorët e angazhuar në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në funksion të përmbushjes së

¹⁹Komenti nr.16 - General Comment No. 16 (2013) of Committee on the Rights of the Child “On State obligations regarding the impact of business on children’s rights”, CRC/C/GC/16

²⁰Komenti nr.20 - General Comment No. 20 (2016) on the implementation of the rights of the child during adolescence CRC/C/GC/20

²¹ Dokumenti “COVID-19 dhe puna e detyruar e fëmijëve: Kohë krize, çasti për të vepruar”, UNICEF, 12.6.2020.

detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, bazuar edhe në Deklaratën e Meridës “Mbi rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” dhe rolit specifik në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, si dhe për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave, për ndryshimin e vendimit nr.108, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e fëmijëve në punë”, në funksion të përmirësimit dhe vendosjes si detyrim ligjor, të lëshimit të autorizimit për grup moshën 16-18 vjeç, nga ISHPSHS, me qëllim kontrollin e punësimit të të miturve të kësaj kategorie.
- Marrjen e masave, për përcaktimin e procedurave të qarta e të sakta, për licencimin e shërbimeve të jashtme të parandalimit, edukimin dhe certifikimin e specialistëve dhe shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, të parashikuara në akte nënligjore.
- Marrjen e masave, për mbledhjen e të dhënave të përditësuara për punën e fëmijëve, si dhe për një bashkërendim më të konsoliduar, eficient dhe të realizuar në kohë e konkret, ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve. Të gjithë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duhet të përfshihen në një kalendar pune të mirëpërcaktuar të aktiviteteve parandaluese për shfrytëzimin e fëmijëve, për të patur një qasje të re pune në koordinimin institucional, brenda vitit 2021, ndërmjet të gjithë mekanizmave shtetërorë përgjegjës, në nivel qendror dhe vendor, për një investim të vlefshëm në drejtëm të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve që shfrytëzohen për punë.
- Marrjen e masave, për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të informimit dhe ndërgjegjësimit publik dhe promovimin për sigurinë dhe shëndetin në punë, si një ndër prioritetet e legjislacionit, për ngritjen e mekanizmit për koordinimin ndërmjet institucioneve shtetërore, që operojnë në fushën e sigurisë në punë, si dhe për ngritjen e Këshillit Ndërministror për Sigurinë e Shëndetin për Punë, si detyrim ligjor që buron nga legjislacioni në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

- Marrjen e masave, për vlerësimin e arritjes së objektivave të Agjendës Kombëtare 2017-2020 për të Drejtat e Fëmijëve, fillimin e procesit të konsultimeve për hartimin e agjendës së re, në kuadër edhe të deklarimit nga OKB, të vitit 2021, “Viti Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve”.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA